



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

14-023/01-63628/26, më 30 APR 2026

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**URDHËRESË**

- I. Ndalohet qarkullimi i të gjitha automjeteve në drejtim të parkut "Gërmia", përveç autobusëve të linjës 4 të NPL "Trafiku Urban", automjeteve të Policisë së Kosovës, të KFOR-it, të EULEX-it, të NPL "Gjelbër", të KRM "Pastrimi", të Drejtorisë së Inspeksionit dhe automjeteve emergjente, për nder të ditës ndërkombëtare të punës - 1 Maj 2026, ndërsa linja S22 e transportit publik do të punojë sipas itinerarit dhe orarit të rregullt deri në Sofali.
- II. Pika përfundimtare për lëvizjen e automjeteve, përveç banorëve të lagjeve: "Normale", "Sofalia", "Tauk-Bahçe" dhe restoranteve: "Gërmia", "Freskia" dhe "Soma", është:
  - Kryqëzimi i rrugëve "1 Tetori" - "Nazim Gafurri" dhe "Ymer Lutfi Paqarizi";
  - Kryqëzimi i rrugëve "Nazim Gafurri" - "Xhavit Ahmeti" dhe "Dr. Lec Gradica";
  - Kryqëzimi i rrugëve "Dr. Shpëtim Robaj" me atë të Sofalisë, më drejtim të pishinës dhe parkut "Gërmia".
- III. Transporti publik i qytetarëve për në parkun "Gërmia" deri te pishina, do të bëhet ekskluzivisht me autobusë të NPL "Trafiku Urban", linja 4.
- IV. Inspektorët e Drejtorisë së Inspeksionit, janë përgjegjës për:
  - Parandalimin e shërbyesve të paautorizuar që të bëjnë shitjen - shërbimin ndaj qytetarëve;
  - Organizimin e kujdestarisë, me qëllim të ruajtjes së ambientit (përdorimin e zjarreve për destinime të ndryshme), si dhe hedhjen e mbeturinave në vende të caktuara.



- V. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
- VI. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e marrjes së saj.

**U DORËZOHET:**

- NPL "Trafiku Urban";
- Drejtorisë së Inspeksionit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
Përparim Rama

